



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

Legjislatura VI  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 18/18  
Prishtinë, më 07.03.2018, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Ali Lajçi, Naser Osmani, Blerim Kuqi, Mërgim Lushtaku dhe Jelena Bontiq.

Munguan: Dardan Molliqaj, Mytaher Haskuka, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza- Ministër i Financave (tutje: Ministri i Financave), Lulzim Rafuna - Kabineti i Ministrisë së Financave, Ismet Aliu-Këshilltar i Ministrisë dhe Salvador Elmazi- Drejtor i Departamentit të Buxhetit të Kosovës.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurije Canolli, Luljeta Krasniqi dhe Eliza Hyseni(praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit, Lumir Abdixhiku (tutje: kryetari).

**R e n d i i d i t ë s :**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.02.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-063 për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Autostradës Kijevë-Zahaq;**
- 4. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2018;**
- 5. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Kamenicës për vitin 2018;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rural;**
- 7. Të ndryshme.**

## 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryetari** konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht pa ndryshime.

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.02.2018

**Kryetari** konstatoi se komisioni unanimisht miratoi procesverbalin, e mbledhjes së mbajtur më 23.02.2018, pa vërejtje.

## 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-063 për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Autostradës Kijevë- Zahaq

**Kryetari** theksoi se ky projektligj ka për qëllim të ratifikojë Marrëveshjen për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Berzhit për ndërtimin e Autostradës Kijevë- Zahaq. Marrëveshja do të fillojë të realizohet nga viti 2018, ku kohëzgjatja e saj është 15 vjet, do të thotë deri në vitin 2033.

**Ministri i Financave** theksoi se marrëveshja në fjalë është një projekt i rëndësisë së veçantë, i cili ka startuar para shumë viteve e ende nuk është përfunduar, dhe fatbardhësisht tash jemi në fazën finale të sigurimit të konstruksioneve financiare për këtë projekt. Ky projekt madhor i Kosovës mund të implementohet në kohë vetëm atëherë kur ministria bartëse të themelojë njësinë e implementimit e cila me kompetencë t'i udhëheq punët dhe zbatojë rregullat e financuesve siç parashihet në këtë marrëveshje. Ne, si Ministri e Financave, ia kemi bërë të qartë ministrisë së linjës se procedurat e prokurimit duhet të zhvillohen në përputhje me rregullat e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe nuk mund të zhvillohen mbi bazën e procedurave të prokurimit që e rregullon infrastruktura vendore këtë çështje. Konstruksioni financiar i marrëveshjes për projekt është 71 milionë euro nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, 80.2 milionë euro nga Banka Investive Evropiane, 38 milionë euro financim nga Buxheti i Republikës së Kosovës, 7.1 milion € grant nga Fondet e Ballkanit Perëndimor për Investime Financiare dhe 0.6 milion grant nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

**Kryetari** theksoi se marrëveshja është pikërisht çfarë ne kërkojmë, që pjesa më e madhe e investimeve kapitale të financohet pikërisht prej këtyre kredive afatgjate, në mënyrë që të lirojmë Buxhetin për të shpenzuar në çështje esenciale në arsim, shëndetësi e gjyqësi. Sa për informacion, marrëveshja ka 24 këste të pagesës ku paguhet dy herë në vit dhe vlera e pagesës është 2.9 milionë euro për këst. Në vazhdim kryetari pyeti për normën e interesit të 71 milionë që do të huazohet.

**Ministri i Financave** sqaroi se norma e interesit është 1% plus eurobor.

**Naser Osmani** theksoi se gjithmonë kemi gatishmëri me i mbështetur këto projekte, të cilat konkretisht shkojnë për investime të kapitalit, sidomos për infrastrukturë. Ne kemi financuar dy autosrtada prej Buxhetit të Kosovës. Po ashtu për rrugën në drejtim të Mitrovicës kemi marrë një kredi nga Banka Islamike, por e cila ende nuk po jetësohet. Sa i perket këtij projekti a pritet që kjo të realizohet menjëherë pas ratifikimit në Parlament dhe të fillojnë procedurat e derdhjes së mjeteve që rruga të vazhdojë sepse është një segment i cili ka filluar qe një kohë të gjatë dhe nuk po përfundon? Për këto projekte kanë qarkulluar informata se ka mundësi të kryhet me donacione, pyetja ime është a ka ndonjëherë përpjekje që të sigurohen donacione të ndryshme për këto investime apo gjithmonë duhet të marrim kredi ose që të financohen prej Buxhetit të Kosovës?

**Ministri i Financave** sqaroi se rruga për Mitrovicë e ka konstruksionin financiar të siguar. Kemi projekte që kemi filluar me klauzonën e investimeve përmes financimit prej Institucioneve Financiare Ndërkombëtare, ku një prej projekteve është edhe ky projekt. Siç e cekta edhe më herët se këto fonde mund të tërhiqen vetëm duke i zbatuar rregullat të cilat në këtë rast i ka Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Njësia implementuese është e themeluar, ministri i linjës ka deklaruar që i ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe paralelisht duke u proceduar marrëveshja prej momentit të nënshkrimit deri në fazën e finalizimit dhe ratifikimit në Kuvend dhe ka mundësi që të zhvillohen procedurat e prokurorimit dhe nëse gjithçka shkon sipas planifikimeve pritet që fundi i pranverës me filluar ekzekutimi i punimeve. Projekti që po flasim është një financim i kombinuar huamarrje me kushte të volitshme prej institucioneve financiare ndërkombëtare në këtë rast Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Bankës Investive Evropiane, një pjesë prej Buxhetit, si dhe një pjesë prej grantit.

**Safete Hadërgjonaj:** Ne, në komision, nuk kemi shumë informata se si ka shkuar rrjedha e zbatueshmërisë së këtyre marrëveshjeve që i kemi ratifikuar në Kuvend. Nga raporti i auditorit të cilin e kemi pasur për vitin 2015, 2016, kemi vërejtur që ka pasur një zbatueshmëri shumë të vogël të këtyre mjeteve, madje edhe në krahasim edhe me ato çka janë prezentuar në buxhet janë shumë të ulëta për të cilat janë diskutuar edhe shumë herë tjera. Meqenëse nga prezentimi që keni bërë dhe nga materiali që ne e kemi për këtë projekt, shohim që ka financim të kombinueshëm, më intereson të dijë se a rrezikon ky financim i kombinueshëm për mos zbatimin e kësaj marrëveshje, si dhe si shkon rrjedha e zbatueshmërisë dhe koordinimit e të gjitha institucioneve në mënyrë që projekti të mos dështon për shkak të mosplotësimit të kushteve që janë përcaktuar.

**Ali Lajçi** pyeti a ekziston mundësia që ky buxhet i akredituar tani për shkak të kredisë, të ridestinohet për tjera linja buxhetore, si dhe nëse mbesin mjetet, si do të menaxhohen mjetet, fondi i këtij buxheti të përgjithshëm a do të jetë i mjaftueshëm?

**Kryetari:** A ka koordinim mes Bankës Investive dhe BERZH-it, pra a ka një trup unifikues që t'i koordinojë të gjitha këto mjetet sepse ka shumë aktorë?

**Ministri i Financave:** Sa i përket koordinimit ekziston një koordinim i plotë mes financuesve të këtij projekti. Me Bankën Investive Evropiane jemi pothuajse në fazën finale të mbylljes së marrëveshjes edhe me këtë institucion. Sa i përket ridestinimit të fondeve nuk ka mundësi për shkak se janë të destinuara për këtë projekt, i cili duhet të kalonte shumë faza deri në momentin e fillimit të negociimit të projektit dhe mbylljes së negociatave për këtë projekt.

**Blerim Kuçi:** Sa i përket trupit koordinues duhet të menaxhohet dhe koordinohet në mënyrë që të funksionojnë sa më mirë dhe se nuk është fare e lehtë të koordinohet duke pasur parasysh edhe mos pajtimet mes ministrive dhe problemet interne, mirëpo trupi zbatues duhet të jetë i mirëkoordinuar.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

### **Rekomandim**

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligji nr. 06/L-063 për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Autostradës Kijevë-Zahaq.

#### **4. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2018**

**Kryetari:** Jemi njoftuar nga Kuvendi Komunal i Suharekës që nuk ka arritur ta votojë buxhetin e komunës brenda afateve ligjore brenda vitit 2018, më 06.02.2018, të cilin Qeveria e Kosovës ka dërguar në Kuvend. Në bazë të shkresës sqaruese të Ministrisë së Financave të bashkëngjitur vendimit të Qeverisë thuhet se Kuvendi Komunal i Suharekës ka miratuar buxhetin e komunës për vitin 2018-2020 në pajtueshmëri me kufijtë buxhetorë të përcaktuar me qarkoret buxhetore. Në propozim buxheti i Komunës së Suharekës për vitin 2018, i miratuar me vonesë, është paraqitur sipas tabelave 4.1, 4.2 dhe 4.3, po ashtu janë të paraqitura në mënyrë të hollësishme të gjitha projektet kapitale. Informatë shtesë për deputetët se një rast të tillë të ngjajshëm e kemi pasur edhe në vitin 2015-2016 për Komunën e Prishtinës, Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Gllogovcit dhe Klllokotit, si dhe këtë vit kemi trajtuar Buxhetin e Komunës së Lipjanit që ishte riaprovuar nga Kuvendet Komunale përkatëse pas fillimit të vitit fiskal.

**Ministri i Financave:** Në rastin e Komunës së Suharekës jemi te situata që parasheh neni 62, pika 4 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ku Kuvendi i Komunës së Suharekës ka aprovuar buxhetin pas aprovimit nga Kuvendi i Kosovës. Komuna e Suharekës e ka aprovuar buxhetin më 31.01.2018, kurse Qeveria e Kosovës e ka miratuar më 28 të vitit 2018, e me këtë buxheti i Komunës së Suharekës për vitin 2018 është 15.350.772 euro, nga 13.783.632 euro ka qenë në vitin 2017, pra bëhet fjalë për një ndryshim prej 1.567.140 euro. E bashkëlidhur është edhe tabela e strukturës së buxhetit për periudhën 2018-2020. Ministria e Financave duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi dhe nevojën që Komuna e Suharekës të ketë mundësi ta ekzekutojë buxhetin pa pengesa dhe rekomandon aprovimin e këtij buxheti për vitin 2018.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

#### **Rekomandim**

Buxheti i Komunës së Suharekës për vitin 2018, i miratuar nga Kuvendi Komunal i Suharekës, më 31.1.2018, të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

#### **5. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Kamenicës për vitin 2018**

**Kryetari** theksoj më tutje drejtuar ministrit të Financave se meqenëse kemi rastin e njëjtë edhe në Komunën e Kamenicës ju lus që ta trajtoni njësoj, prandaj nëse nuk keni diçka shtesë po i trajtojmë të dyja bashkë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

#### **Rekomandim**

Buxheti i Komunës së Kamenicës për vitin 2018, i miratuar nga Kuvendi Komunal i Kamenicës më 6.2.2018, të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

## **6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rural**

**Kryetari** theksoi se ky ligj përcakton kompetencat dhe të hyrat e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës duke përfshirë veprimtarinë e fushave në Shkencat Gjeologjike në territorin e Republikës së Kosovës. Opinioni i Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave që ka vlerësuar se zbatimi i ligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës do të prodhojë kosto shtesë në shumën prej 60.000 € në kategorinë ekonomike në paga dhe mëditje, dhe rritjeve të punëtorëve për 11 pozita dhe kjo shumë nuk është paraparë në buxhetin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për vitin 2018 dhe parashikimet afatmesme buxhetore.

**Ministri i Financave** theksoi se sa i përket iniciativave të reja ligjore Ministria e Financave është duke u përballur me një presion për ndikim në buxhet për projektligje, të cilat patjetër janë të nevojshme. Mirëpo organizata buxhetore duhet fillimisht t'i vendosë brenda kufijëve buxhetorë, ashtu si e kërkon edhe Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, pastaj të procedojnë me të njëjtat e të ndalojnë me kërkesat, iniciativa të reja ligjore, strategji të reja të cilat e tejkalojnë dhe janë mbi kufijtë buxhetorë, për shkak se vijnë në një situatë ku duhet të shkurtohet fondi i ndonjë organizate buxhetore ose mbesin ligje të aprovuara e të pa implementuara. Ndërsa, sa i përket ligjit konkret, Ministria e Financave besoj fuqishëm edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa është një kosto e cila nuk është brenda kufijëve buxhetorë, mirëpo si e tillë nuk e ngarkon dhe rrezikon qëndrueshmërinë makrofiskale të vendit flasim për një kosto 60.000 € e duke pasur parasysh rëndësinë e ligjit i cili është i nevojshëm dhe ne, si Ministri e Financave i rekomandojmë komisionit, që ligjin ta aprovojë dhe ta procedojë brenda në Kuvend.

**Safete Hadërgjonaj** theksoi se ne jemi të disponuar që në Komision të mos na vijnë fare ato ligje që e mbingarkojnë buxhetin me kosto, sepse kur deklarata e Ministrisë së Financave që ligji ka kosto buxhetore dhe nuk është e përfshirë në buxhet, e as në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve atëherë paraqitet problem për komisionin që ta kalojë një ligj të tillë. Ne kemi qenë të interesuar ta implementojmë si nen të veçantë në kuadër të Ligjit të Buxhetit, mirëpo nuk e kemi bërë këtë gjë për shkak të ligjeve të cilat janë në interes për vendin, e nganjëherë kam përshtypjen se edhe nga analiza jo e mirë për të cilën nuk po janë shumë ekspertë për vlerësimin e ligjit e ky i fundit, po ngarkohet si konkluzion të mos zbatimit të tyre dhe si pasojë e kësaj po marrim vërejtje nga Komisioni Evropian për mos zbatueshmërisë së ligjit. Prandaj, e cilësoj si çështje pak shqetësuese, kur ligji të vjen në Kuvend, dhe Ministria e Financave thotë se ka kosto buxhetore dhe ne, në Komision, duhet që ta kalojmë atë ligj.

**Kryetari:** Realisht këto projektligje po vijnë prej Qeverisë si të tilla me kosto shtesë buxhetore, fillimisht Qeveria duhet të ndalë ligjin para se të vijë te ne në Kuvend.

**Ministri i Financave** – Ne, si ministri, shumë shpesh jemi në një situatë jo e këndshme brenda Qeverisë, nga ministria në fjalë është bërë e qartë se nëse rekomandimi i ministrisë dhe nga deklarata financiare prej kësaj ministrie vjen se ligji nuk është brenda kufijve buxhetorë, ashtu siç e kërkon Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, atëherë nuk duhet as të vendoset si pikë e rendit të ditës. Shtoj më tutje se nevojat duhet të financohen brenda mundësive reale buxhetore dhe Ministrinë e caktuar dhe kolegë të mijë me shumë respekt nuk është mirë me koncentruar të gjithë presionin te Ministria e Financave dhe si ministria, ashtu edhe Komisioni për Buxhet nuk ka buxhet rezervë.

**Kryetari:** Do të bëjmë çfarë është e mundur në kompetencat tona që edhe projektet që vijnë të tilla prej Qeverisë, por që kanë kosto të mos i trajtojmë më tutje sepse është në vijë me kufizimet buxhetore që i kemi. Meqenëse kjo nuk ka kosto të lartë dhe është e përballeshme po e hedh në votim.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

### **Rekomandim**

1. Projektligji nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, për Projektligjin nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

### **7. Të ndryshme**

**Kryetari:** Administrata e Kuvendit, ka nftotuar se ka pranuar kërkesën nga Ministria e Financave për të hartuar KASH-in e Kuvendit. Meqenëse duhet ta formojmë një grup punues dhe propozojë: Blerim Kuçi (kryesues) dhe Ali Lajçi (anëtar).

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri vendosi për krijimin e grupit punues për shqyrtimin e kërkesave të Kuvendit të Kosovës lidhur me KASH-in 2019-2021. Grupi punues, për punën e tij, raporton në komision.

**Kryetari** më tutje diskutoi për raporte financiare të paaudituar të institucioneve të pavarura, ku të njëjtat raporte auditohen gjatë vitit dhe trajtohen në Komisionin për Mbikqyrjen e Financave Publike, do të thotë ato shqyrtohen dy herë. Pra, njëherë trajtohet raporti i paaudituar te ne. Ne e dërgojmë në seancë, seanca e voton më pas i njëjti raport auditohet shkon në Komisionin për Mbikqyrjen e Financave Publike e këta të fundit prapë e dërgojnë në seancë, përsëri seanca e voton, pra konkretisht i njëjti raport votohet dy herë. Dua ta diskutoj këtë çështje, pse duhet dy komisione ta trajtojnë një raport të njëjtë, a do të ishte më mirë t'i ndajmë agjensitë apo të bashkëpunojmë me ta sepse nuk më duket e arsyeshme.

**Naser Osmani:** E kemi diskutuar shpesh këtë çështje dhe kemi ardhur në përfundim se faktikisht këto raporte dy herë po kalojnë në Komisionin për Mbikqyrje dhe Komisionin për Buxhet, për të cilin kemi kërkuar një koordinim me komisionin përkatës dhe nuk mendoj se natyra e këtij raporti lidhet me ne. Propozoj të koordinohemi me komisionin përkatës, ku ne vetëm t'i marrim raportet financiare dhe t'i trajtojmë, mirëpo jo t'i përcjellim në seancë, përderisa komisioni përkatës nuk e ka trajtuar. Sa i përket seancës konsideroj se duhet të përcjelllet me raport të auditimit.

**Blerim Kuçi:** Përveç asaj që tha z. Osmani, ndoshta ne duhet të bisedojmë edhe me zyrën e Auditorit të Përgjithshëm në mënyrë që ata të kenë prioritet kohor ku raportet shkojnë përmes Komisionit, pra ata t'i shqyrtojnë dhe t'i kryejnë të parët.

**Naser Osmani:** Varësisht nga specifika e agjencive, disa prej tyre nuk i kontrollojnë Zyra e Auditorit Gjeneral të cilat nuk janë pak, prandaj duhet të bëjmë zgjidhje sepse nuk mund të shkojnë dy herë në seancë për të njëjtin raport. Ne mund të bëjmë vërejtje në realizimin e tyre, tejkalin e shpenzimeve apo mosrealizimin e atyre shpenzimeve që kanë qenë të ndara për buxhet, mirëpo ne nuk mund të bëjmë vërejtje të cilat auditori i jep me rekomandime, atë mund ta bëjë vetëm Komisioni për Mbikqyrje.

**Sadete Hadërgjonaj:** Pothuajse të gjitha i përfshiu Naseri, të them të drejtën neve ngapak po na imponojnë ndërkombëtarët themelimin e komisioneve, ndërkaq më së miri do të kishte me qenë që

Komisioni për Mbikqyrje të jetë në kuadër të Komisionit për Buxhet, por me qenë si nënkomision i rregullt dhe që e udhëheq opozita, me qenë numri më i madh i anëtarëve të Komisionit për Buxhet, në mënyrë që të kemi qasje në raporte të auditorit dhe në raportet financiare.

Në ligjet të cilat parashihet raportimi i Institucioneve të Pavarura, thotë se raportit të punës i bashkangjitet edhe raporti financiar, pra nuk thotë raporti i audituar, dhe në bazë të këtij raporti financiar ne, si Komision, për Buxhet nuk merremi me problematikën e efektshmërisë dhe efikasitetit të shpenzimeve të mjeteve në institucion, në qoftë se ata kanë bërë shkelje kjo është çështje që e verifikon auditori. Neve na intereson çka është planifikuar dhe sa është realizuar buxheti i planifikuar, dhe kjo na ndihmon ne të dimë se si ka shkuar rrjedha e realizimit të buxhetit nga ajo që është planifikuar. Nëse ndryshojmë këtë çështje duhet t'i ndërrojmë edhe ligjet të cilat në numër afërsisht janë 30-40 të tilla që duhet të ndryshojnë. Te ne do të vijë edhe raporti financiar i Qeverisë i paaudituar të cilin na vjen tash, e të cilin kemi për ta shqyrtuar dhe votuar, e raporti i audituar vjen në shtator, e me qenë se është kështu ne e analizojmë për nga aspekti i planifikimit dhe realizimit. Ne nuk marrim përgjegjësi nëse kanë ndodhur shkelje të prokurorimit gjatë harxhimit, a i kanë shpenzuar mirë apo keq.

**Mbledhja përfundoi në orën 10:50.**

**Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit**

**Kryetari komisionit,**

-----

**Lumir Abdixhiku**